Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Nr:02-3722/14
27.10.2026
Shkup

PROCESVERBAL
nga seanca e 34-ët e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele të mbajtur me datë 20.10.2026

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:

- **Kryetari i Këshillit:** Mr. Sasho Stefanovski
- **Zëvendëse e kryetarit të Këshillit:** Mr. Zirjeta Jajaga
- **Anëtarët e Këshillit:** Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, mr. Gordana Majnova, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavllovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /.

Të pranishëm nga drejtuesit e Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe Muhamer Beqiri, zëvendës i drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pransishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Maja Damevska, Magdalena D. Dovleva, Emilija Janevska, Ivona Mufisheva dhe Sergej Todorovski.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 34-ët të Këshillit. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 7 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 05.10.2026.

2. Shqyrtimi i raporteve tremujore mbi punën e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 korrik deri më 30 shtator 2026.

3. Propozim- vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Dibrës.

4. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio 99 ShPKNJP Shkup.

5. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Buba Mara Ranko ShPKNjP Shkup.

6. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Lajf radio ShPKNJP Shkup.

7. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Ekspres-radio ShPKNjP Strumicë.

8. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR TV News ShPKNJP Kumanovë, për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) të LShMAAV-së.

9. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR TV News ShPKNJP Kumanovë, për shkelje të nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së.

10. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR TV News ShPKNjP Kumanovë, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.

11. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR Radio 106 Manastit ShPKNjP.

12. Propozim-vendim për pagesën e kompensimit për vdekjen e një anëtari të ngushtë të familjes punonjësi të Agjencisë.

13. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të lëndës në vijim - mallra: energji elektrike.

14. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim – mallra: furnizime zyre.

15. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 05.10.2026.

Pika 2

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, sqaroi se në kuadër të kësaj pike do të shqyrtohen raportet tremujore për punën e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 korrik deri më 30 shtator 2026, dhe për këtë pikë nuk do të ketë votim.

Udhëheqësja e Sektorit për koordinim dhe përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, mr. Dragica Ljubevska, bëri një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara në periudhën raportuese në kuadër të zbatimit të Programit të Punës së Agjencisë.

Në lidhje me mbikëqyrjet programore, ajo informoi se janë kryer mbikëqyrje mbi shërbimet programore RTM 1, RTM 2 dhe RTM 5, mbi nëntë televizionet komerciale kombëtare, si dhe mbi ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele.Nga mbikëqyrjet është konstatuar se të gjitha subjektet e përfshira nga mbikëqyrja e kanë përmbushur detyrimin për miratimin e plan veprimit për akses dhe për të paraqitur në Agjenci raport vjetor për vitin paraprak. Njëkohësisht, është konstatuar se shërbimet programore RTM 1, RTM 5 dhe TV Kompani 21-M nuk kanë paraqitur raport mbi zbatimin e planit të veprimit për akses në afatin e përcaktuar ligjor, përkatësisht deri më 31 mars 2026.

Mbikëqyrje të rregullta programore u kryen gjithashtu në gjashtë televizione komerciale dhe gjashtë televiyione lokale. Shkelje u konstatuan tek TV Star në lidhje me rregullat për transmetimin e komunikimeve komerciale për alkoolin dhe pijet alkoolike, si dhe ndalim për rekomandim të veçantë për blerjen ose marrjen me qira të mallrave ose shërbimeve. Shkelje të rregullave për programin e krijuar burimor u konstatuan tek TV Gurra, G-TV, TV Due dhe TV News.

Mbikëqyrje u krye edhe mbi radiot kombëtare si Antena 5, Kanal 77, Jon dhe Metropolis, dhe nuk u konstatuan shkelje.

Në periudhën raportuese, Agjencia ka kryer gjithsej 22 mbikëqyrje të rregullta dhe dy mbikëqyrje kontrolli mbi operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik, në lidhje me respektimin e rregullave për përdorimin e gjuhës, regjistrimin e detyrueshëm të shërbimeve programore që ritransmetohen dhe përfshirjen e detyrueshme të shërbimeve programore të Radiotelevizionit të Maqedonisë. Tek mbajtësit e të drejtave u dërguan tre njoftime për ritransmetim të paligjshëm të shërbimeve programore që nuk ishin të regjistruar në Agjenci.

Lidhur me mbikëqyrjen administrative, Ljubevska informoi se janë kryer mbikëqyrje të rregullta për respektimin e rregullave për publikimin e informacionit në dispozicion të përdoruesve, të dhëna për impresium dhe identifikimin e transmetuesit tek radiot komerciale kombëtare, gjashtë shërbime programore televizive lokale dhe gjashtë rajonale. Shkelje u konstatuan tek TV Gurra , TV Due, TV News dhe TV Star.

Përveç kësaj, u krye mbikëqyrje e rregullt mbi të gjithë transmetuesit në lidhje me detyrimin për publikimin e të dhënave mbi strukturën pronësore, stafin editorial dhe burimet e financimit për vitin paraprak, si dhe për të paraqitur regjistrim në Agjenci. U konstatua se të gjithë transmetuesit e kishin përmbushur këtë detyrim.

Në rastet kur u konstauan shkelje, u krye mbikëqyrje kontrolli. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia lëshoi dhjetë aktvendime për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj pesë transmetuesve, tre aktvendime ndaj operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe një masë ndaj botuesi të medias së shtypit.

Agjencia veproi gjithashtu mbi një njoftim për ndryshimin e strukturës pronësore të TV 24 Vesti, me ç'rast lëshoi aktvendim për refuzimin e njoftimit. Përveç kësaj, u lëshuan dy aktvendime për pezullimin e procedurës për vendimmarrje mbi njoftimet për ndryshimin e strukturës pronësore të RFM dhe Nasha TV, në pritje të përfundimit të procedurave mbi një çështje të ngritur pranë organi tjetër kompetent.

Përveç kësaj, Ljubevska informoi se është marrë vendim për të refuzuar kërkesën me shkrim për shpalljen e konkursit publik për komunën e Kavadarit, sepse nga studimi i përgatitur u arrit në përfundim se nuk ekziston arsyetim për shpalljen e konkursi publik.

Në fushën e arsimimit mediatik u mbajtën disa takime, përfshirë me përfaqësues të Këshillit të Evropës dhe IFES-it. U përgatitën dhe u përditësuan kontributet për raportin e Komisionit Evropian, si dhe u mbajt takimi i tretë publik. Në të njëjtën kohë, u përditësua rregullisht faqja e internetit të Agjencisë, u publikuan disa njoftime për shtyp dhe iu përgjigjën disa ankesave.

Si pjesë e aktiviteteve të zbatuara, u përgatit edhe një Analizë e strukturës së të punësuarve dhe një Studim për përcaktimin e arsyes për shpallje të konkursit publik.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena D.Dovleva informoi se, bazuar në kërkesë të paraqitur nga palë e interesuar dhe pasi u konstatua se ka frekuenca të lira radiofonike, është përgatitur Studim për të përcaktuar arsyeshmërinë e shpalljes së konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Dibrës. Ajo theksoi se gjetjet e Studimit tregojnë arsyeshmërinë e shpalljes së konkursi publik, kryesisht sepse nuk ka transmetim në radio lokal në zonën e komunës së Dibrës. Edhe pse potenciali ekonomik i tregut lokal është i kufizuar, analiza tregoi se ekzistojnë kapacitete për qëndrueshmërinë e një radioje, gjë që u konfirmua edhe përmes një analize krahasuese me komunat me potencial të ngjashëm ekonomik, numër banorësh dhe numër subjektesh afaristë që janë aktivë. Duke marrë parasysh strukturën e popullsisë në komunën e Dibrës, Magdalena D. Dovleva shpjegoi se Studimi parashikon shpalljen e një konkursi publik për dhënien e lejes për radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, pjesa e folur e të cilit do të transmetohet në gjuhën maqedone dhe shqipe.

Mr Ivona Mufisheva, ndihmës-udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, e shpjegoi propozim-vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e një leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Dibrës, për shërbim programor - radio muzikore-folëse me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedone dhe shqip, e cila do të transmetohet në frekuencën radiofonike 88.1 MHz . Ajo shpjegoi se dokumentacioni i konkursit përmban propozim-kërkesë dhe një propozim-tekst të konkursit publik, të cilat përcaktojnë mënyrën dhe formën e dorëzimit të kërkesës, numrin e kopjeve dhe përmbajtjen e detyrueshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 60 ditë, duke llogaritur nga dita e parë pas publikimit të konkursit publik në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Këshilltarja Afrona Vrzivoli pyeti nëse shuma prej 60.000,00 denarë, e cila paguhet në llogarinë e Agjencisë në lidhje me pjesëmarrjen në konkursin publik, përbën një kompensim të pakthyeshme. Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, sqaroi se mjetet janë të pakthyeshme, duke marrë parasysh se Agjencia ka shpenzime që lidhen me shpalljen e konkursit publik.

Pas shqyrtimit të materialeve dhe shpjegimeve të dhëna, Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Dibrës, për shërbim programor - radio muzikore-folëse me format të përgjithshëm, në gjuhën shqipe dhe maqedone, e cila do të transmetohet nëpërmjet frekuencës radiofonike 88.1 MHz , të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike. Leja do të jepet për periudhë prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Sektori për koordinim dhe përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë është i detyruar ta publikojë Vendimin në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë, si dhe së paku në dy gazeta ditore, njëra prej të cilave është në gjuhën e bashkësisë joshumocë, të cilën e flasin së paktu 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Pikat 4, 5, 6 dhe 7

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, sqaroi se pikat 4, 5, 6 dhe 7 i referohen vazhdimit të lejeve për transmetim në radio të katër transmetuesve. Ai informoi se gjatë periudhës në të cilën ata i posedonin lejet, nga asnjë transmetues nuk u konstatua shkelje të Kodit Zgjedhor të konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, as nuk kishte shkelje të dispozitave të veçanta të nenit 48 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Bazuar në sa më sipër, drejtori propozoi që transmetuesve tu vazhdohen lejet për transmetim në radio për periudhë nëntëvjeçare, duke filluar nga 5 janar 2027. Meqenëse arsyetimi për të katër pikat është i njëjtë, ai tregoi se Këshilli mund t'i shqyrtojë ato së bashku dhe të marrë vendim për secilën pikë veçmas.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio 99 ShPKNJP Shkup, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio 99 ShPKNJP Shkup, PA1 nr. 0802-107 të datës 06.03.2024, vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhë prej 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe do t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Buba Mara Ranko ShPKNJP Shkup, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Buba Mara Ranko ShPKNjP Shkup, PA1 nr.08-68 të datës 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe do t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Lajf Radio ShPKNjP Shkup, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Lajf Radio ShPKNJP Shkup, PA1 nr.08-73 të datës 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit do ta publikojë Vendimin e lartpërmendur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe do t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 7

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Express-radio ShPKNJP Strumicë, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Express-radio ShPKNJP Strumicë, PA1 nr.08-127 të datës 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe do t'ia dorëzojë transmetuesit.

Pikat 8, 9 dhe 10

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, propozoi që shpjegimi për pikat 8, 9 dhe 10 të jepen së bashku, duke pasur parasysh se të tre pikat i referohen të njëjtit transmetues, ShTR TV News ShPKNJP Kumanovë.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, Emilija Janevska, informoi se gjatë mbikëqyrjes së rregullt programore dhe administrative të shërbimit programor të ShTR TV News ShPKNJP Kumanovë, të kryer në shtator 2026, u konstatuan tre

shkelje, dy prej të cilave ishin të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe një e Ligjit për Media.

Në lidhje me pikën 8, ajo shpjegoi se u konstatua shkelje e nenit 92, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e cila përcakton detyrimin e shoqërive tregtare radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive në baza ditore për të ofruar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuele maqedonase. Nga mbikëqyrja e kryer u konstatua se transmetuesi në ditën e analizës transmetoi 24.22% program të krijuar burimor, në vend të 30% të përcaktuar me ligj. Mungesa është afërsisht 1 orë, 19 minuta dhe 50 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Në lidhje me pikën 9, Janevska informoi se është konstatuar shkelje e nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, i cili i referohet detyrimit të ofruesit të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë, të lehtë dhe të përhershme në informacionin që duhet t'u jetë i disponueshëm përdoruesve. Ky informacion, ndër të tjera, përfshin emrin dhe adresën e plotë të selisë së ofruesit të shërbimit, të dhënat e kontaktit, duke përfshirë numrin e telefonit, adresën e email-it dhe faqen e internetit, të dhënat e personit përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas, si dhe të dhënat e organit rregullator kompetent.

Në lidhje me pikën 10, ajo sqaroi se u konstatua shkelje e nenit 14 të Ligjit për Median, përkatësisht të detyrimit për publikim impresium. Nga mbikëqyrja u konstatua se në dy programe fetare të transmetuara më 4 shtator 2026, kur u krye mbikëqyrja, nuk u publikuan të dhënat për impresium.

Janevska informoi se për shkeljet e konstatuara transmetuesi paraqiti një deklaratë me shkrim, duke deklaruar se ishte një gabim teknik i paqëllimshëm dhe se do të merrte masat e nevojshme për të eliminuar gabimet dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre. Deklarata ishte pjesë përbërëse e materialeve të paraqitura për seancën.

Pas prezantimit të gjetjeve të mbikëqyrjes, Drejtori i Agjencisë propozoi që për secilën nga tre shkeljet, të miratohet Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik, të cilit transmetuesi urdhërohet në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e ligjit. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendime, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.10-3510/1 të datës 25.09.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV News ShPKNjP Kumanovë t'i shqiptoi masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) të LShMAAV-së dhe në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst ipastruar) nr. 01-4241/1 të datës 01.10.2025, t'i urdhërojë

në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e nenit 92, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit do ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në faqen e internetit të Agjencisë.

Votimi për pikën 9

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. 10-3505/1 të datës 25.09.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV News ShPKNJP Kumanovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së dhe, në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 01.10.2025, urdhërohen që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje programore dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Votimi për pikën 10

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt administrative, nr.10-3507/1 të datës 25.09.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare RAdiodifuzive TV Wez ShPKNjP Kumanovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media dhe, në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndëmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 01.10.2025,

urdhërohet në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike urdhërohet të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 11

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit, Magdalena Dovleva Davidovska, informoi se më 5 tetor 2026, radiostacioni "Radio Stacioni 106" nga Manastiri dorëzoi një njoftim për ndryshim në strukturën e pronësisë. Pas kontrollit të kryer, u përcaktua se njoftimi ishte në rregull dhe përmbante të dhënat dhe dokumentet shoqëruese të nevojshme, prandaj Agjencia vazhdoi të shqyrtojë nëse ndryshimi i propozuar do të krijonte përqendrim mediatik të paautorizuar në kuptim të dispozitave të Kapitullit IV të Ligjit për Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ajo sqaroi se, sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, personi fizik i propozuar si pronar i ri i radiostacionit nuk ishte i regjistruar si themelues i një shoqërie tregtare, as si pronar përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Në bazë të kontrolleve të kryera, u konstatua se ndryshimi i planifikuar në strukturën e pronësisë nuk do të krijojë një përqendrim mediatik të paautorizuar dhe se ndryshimi nuk është në kundërshtim me dispozitat e Kapitullit IV të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Prandaj, Dovleva Davidovska propozoi që të miratohet vendim me të cilin miratohet ndryshimi në strukturën e pronësisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejohet ndryshim në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio 106 Manastir ShPKNJP, me tekstin e propozuar. Ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiotelevizive Radio 106 Manastir ShPKNjP nuk krijojnë një përqendrim mediatik të paautorizuar, përkatësisht ndryshimi nuk është në kundërshtim me ndalimin e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LShMAAV-së.

ShTR Radio 106 Manastir ShPKNJP është e detyruar që, pas ndryshimit, t’i paraqesë Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele statusin aktual të lëshuar nga Regjistri Qendror i RMV-së.

ShTR Radio 106 Manastir ShPKNjP është e detyruar ta zbatojë ndryshimin në strukturën e pronësisë në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 ditësh nga data e miratimit të Vendimit, përndryshe Vendimi do të anulohet pas skadimit të afatit të caktuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin do ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 12

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi se propozim-vendimi ka të bëjë me pagesën e kompensimit financiar për një punonjëse të Agjencisë për shkak të vdekjes në familjen e saj të ngushtë. Ai theksoi se, në pajtim me dispozitat ligjore dhe Marrëveshjen Kolektive, punonjësja ka të drejtë për kompensim të përshtatshëm financiar, shuma e të cilit dhe emri i përfituesit paraqiten në propozim-vendimin. Për shkak të natyrës së të dhënave personale të përfshira në vendim, detajet në lidhje me përfituesin e kompensimit nuk u paraqitën më tej në diskutim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi pagesën e ndihmës financiare - kompensim për vdekjen e një anëtari të ngushtë të familjes. Mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 13

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, informoi se kjo është një procedurë në vazhdim për furnizimin publik të energjisë elektrike, e cila po zbatohet si furnizim publik në grup së bashku me Ministrinë e Sportit.

Kur u pyet nga Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, nëse një furnizim i tillë shpallet një herë në vit, drejtori konfirmoi se bëhet fjalë për procedurë të rregullt vjetore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: energji elektrike.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për mallrat: energji elektrike, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr. 05-2743/1 të datës 13.07.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 14

Mr. Ivona Mufishev , ndihmës - udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, informoi se propozim-vendimi ka të bëjë me zbatimin e furnizimit publik të materialeve për zyrë, të nevojshme për punën e përditshme të punonjësve dhe për kryerjen pa probleme të detyrimeve të punës në Agjenci. Ajo shpjegoi se për zbatimin e furnizimit është e nevojshme mjete financiare në shumën totale prej 305.000,00 denarë pa TVSH, të cilat sigurohen në pajtim me Planin Financiar të

Agjencisë. Procedura për dhënien e kontratës do të zbatohet në pajtim me Ligjin për furnizime publike,si furnizim me vlerë të ulët.

Mufisheva shtoi se ky është furnizim i rregullt që Agjencia kryen çdo vit për të siguruar materiale zyre.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për të kryer procedurën e furnizimit publik - mallra: materiale zyre.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për mallra: materile zyre është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr. 05-2743/1 të datës 13.07.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 15 – Të ndryshme

Nën pikën "Të ndryshme" nuk u shqyrtuan çështje të tjera.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski